



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 05.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **SH.Drini Company**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Zgjerimi i rrugës “Martirët e Kombit”- hyrja perëndimore e qytetit**”, Nr. i prokurimit-632-23-4748-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-056 -511, **nxjerr:**

### V E N D I M

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **SH.Drini Company**, e dt.31.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Zgjerimi i rrugës “Martirët e Kombit”- hyrja perëndimore e qytetit**”, Nr. i prokurimit- 632-23-4748-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-056 -511, kundër **DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË**, të publikuar me datë 29.05.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 29.05.2023;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

Operatori Ekonomik **SH.Drini Company**, me dt.31.05.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi i rrugës “Martirët e Kombit”- hyrja perëndimore e qytetit**”, Nr. i prokurimit- 632-23-4748-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-056 - 511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 05.06.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është pjesërisht i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

